



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



ZRRE/Rregulla Nr. 03/2026

RREGULLA PËR GARANCITË E ORIGINËS

Prishtinë, 22 prill 2026



Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, në përputhje me autoritetin e dhënë me Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafin 1.7, Nenin 25 dhe Nenin 26 të Ligjit (Nr. 05/L-084) për Rregullatorin e Energjisë, dhe Nenet 53, 54, 55, 56, 57, 58 dhe 59 të Ligjit (Nr. 08/L-258) për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë, në seancën e mbajtur me 22 prill 2026, miratoi:

RREGULLA PËR GARANCITË E ORIGINËS

PJESA I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj Rregulle është të përcaktojë procedurën për lëshimin, transferimin dhe anulimin e Garancive të Origjinës për energjinë elektrike të gjeneruar bazuar në Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë në Kosovë.
2. Kjo Rregull përcakton:
 - 2.1. të drejtat dhe detyrimet e Organit Lëshues;
 - 2.2. regjistrimin e Pajisjeve të Gjenerimit dhe regjistrimin e Llogarive në Regjistrin e Garancive të Origjinës;
 - 2.3. procedurën e lëshimit, transferimit dhe anulimit të Garancive të Origjinës si dhe
 - 2.4. parimet e llogaritjes dhe publikimit të Përzierjes së Mbetur.

Neni 2 Përkufizime

1. Termet e përdorura në këtë Rregull kanë kuptimin e mëposhtëm:
 - 1.1 **Llogari** – do të thotë një llogari që është në Regjistrin e Garancive të Origjinës ose një Llogari e Transferueshme ose një Llogari Anulimi.
 - 1.2 **Mbajtësi i Llogarisë** – do të thotë personi, qoftë Prodhuesi i BRE-ve, subjekti i caktuar për të kryer detyrat e Operatorit të Energjisë së Ripërtëritshme, ose furnizuesi, në lidhje me të cilin është hapur një Llogari dhe mbahet në Regjistrin e Garancive të Origjinës.
 - 1.3 **Llogari Anulimi** – do të thotë një regjistrim në Regjistrin e Garancive të Origjinës që lidhet me një Mbajtës të caktuar Llogarie që përfshin certifikata mbi Garancitë e Origjinës të cilat janë anuluar nga ai Mbajtës Llogarie, ose të cilat i janë transferuar atij personi në lidhje me Anulimin e tyre nga një Mbajtës tjetër Llogarie.
 - 1.4 **Llogari e Transferueshme** – do të thotë një regjistrim në një Regjistër të Garancive të Origjinës që lidhet me një Mbajtës të caktuar Llogarie që përfshin:
 - 1.4.1 Garancinë e Origjinës të lëshuar për atë Mbajtës Llogarie; dhe
 - 1.4.2 Garancinë e Origjinës të transferuar nga një Mbajtës tjetër i Llogarisë; që në cilindo rast, më pas nuk:



- 1.4.2.1 janë transferuar në një Llogari tjetër të Transferueshme në Regjistrin e Garancive të Origjinës;
 - 1.4.2.2 janë anuluar;
 - 1.4.2.3 kanë skaduar, ose
 - 1.4.2.4 janë tërhequr.
- 1.5 **Aplikues** – do të thotë personi fizik ose juridik që aplikon për:
 - 1.5.1 regjistrimin e Pajisjes së Gjenerimit, ose
 - 1.5.2 regjistrimin e Llogarisë.
- 1.6 **Dita** - do të thotë ditët e punës të javës siç përcaktohen në legjislacionin e Kosovës.
- 1.7 **Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE)** – do të thotë agjenci e pavarur në sektorin e energjisë, e themeluar me ligjin për Rregullatorin e Energjisë.
- 1.8 **Organ Lëshues** – do të thotë ZRRE-ja e cila vepron si autoritet përgjegjës për lëshimin e Garancive të Origjinës për territorin e Republikës së Kosovës, të përcaktuara me Ligjin (08/L-258) për Promovimin e Përdorimit të Burimet e Ripërtërishme të Energjisë.
- 1.9 **Ministria** – do të thotë ministria përgjegjëse për sektorin e energjisë në Republikën e Kosovës.
- 1.10 **Organi Matës** – do të thotë operatori i licencuar i sistemit të transmetimit ose operatori i sistemit të shpërndarjes për territorin e Republikës së Kosovës, secili përgjegjës për mbledhjen e vlerave të matura të injektimit nga Pajisja e Gjenerimit dhe për ofrimin e të dhënave të verifikuara të matjes të ZRRE-ja si Organ Lëshues për qëllime të lëshimit të Garancive të Origjinës.
- 1.11 **Burimet Ripërtërishme të Energjisë (BRE)** – do të thotë burimet jo-fosile, përkatësisht energjia e erës, energjia diellore (diellore termike dhe diellore fotovoltaike) dhe gjeotermale, energjia e ambientit, energjia hidroelektrike, biomasa, gazi i deponive, gazi i impiantit të trajtimit të ujërave të zeza dhe biogazi.
- 1.12 **Operatori i Energjisë së Ripërtërishme** – do të thotë subjekti i caktuar për të qenë palë homologe e Prodhuesve të Energjisë së Ripërtërishme që përfitojnë nga Skema Mbështetëse dhe është përgjegjës për menaxhimin e Fondit Mbështetës për Energjinë e Ripërtërishme.
- 1.13 **Prodhues i BRE-ve** – do të thotë çdo prodhues që gjeneron energji bazuar në teknologjitë e ripërtërishme, duke përfshirë vetë-konsumatorët e burimeve të ripërtërishme.
- 1.14 **Vetë-konsumatorët e Energjisë së Ripërtërishme** - do të thotë konsumatori fundor që operon brenda hapësirave të tij, që prodhon energji elektrike të Ripërtërishme për konsum vetanak, i cili mund të ruajë ose shesë energji elektrike të Ripërtërishme të prodhuar nga vetë ai, me kusht që, për një Vetë-konsumator të Burimeve të Ripërtërishme jo-familjar, këto veprimtari nuk përbëjnë veprimtarinë e tij kryesore tregtare ose profesionale.
- 1.15 **Ligji për BRE-të** – do të thotë Ligji (Nr. 08/L-258) për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë.



- 1.16 **Përzierja e Mbetur** – do të thotë llogaritja e përdorur për të përcaktuar origjinën e energjisë për konsumin e pakontrolluar, përkatësisht përzierjen totale të gjenerimit vjetor të energjisë elektrike në Republikën e Kosovës e cila nuk gjurmohet në mënyrë të qartë përmes Garancive të Origjinës ose ndonjë sistemi tjetër të besueshëm të gjurmimit, e llogaritur çdo vit nga ZRRE.
 - 1.17 **Regjistri i Garancive të Origjinës** - do të thotë regjistri elektronik i krijuar dhe i mirëmbajtur nga ZRRE-ja, me qëllim lëshimin, transferimin dhe anulimin e Garancive të Origjinës, në përputhje me Standardin Evropian CEN 16325 dhe Parimet dhe Rregullat e Operimit të Sistemit Evropian të Certifikimit të Energjisë (EECS).
 - 1.18 **Pajisja e Gjenerimit** – do të thotë një pajisje ose grup pajisjesh të matura veçmas që gjeneron energji elektrike.
 - 1.19 **Garancitë e Origjinës** - do të thotë një dokument elektronik (një certifikatë) që ka funksionin e vetëm të ofrojë prova për konsumatorin përfundimtar se një pjesë ose sasi e caktuar e energjisë është gjeneruar nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë dhe që mund të përdoret edhe për qëllime shitjeje nga mbajtësi i Garancisë së Origjinës.
 - 1.20 **Shoqata e Organeve Lëshuese** (Association of Issuing Bodies - AIB) - është institucion me seli në Bruksel, i cili garanton origjinën e energjisë së Evropës. Qëllimi i AIB është që të zhvillojë, të përdorë dhe promovojë një sistem të standardizuar për CeO: Sistemi Evropian i Certifikimit të Energjisë (EECS - the European Energy Certificate System).
2. Çdo term që nuk është përcaktuar me këtë Rregull duhet të interpretohet në pajtim me Ligjin (08/L-258) për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

PJESA II

ORGANI LËSHUES, PËRSHTATSHMËRIA DHE REGJISTRI I PAJISJEVE TË GJENERIMIT

Neni 3

Organi Lëshues

1. ZRRE është Organi Lëshues përgjegjës për lëshimin, transferimin dhe anulimin elektronik të certifikatave të Garancive të Origjinës në territorin e Republikës së Kosovës.
2. ZRRE-ja zhvillon sisteme, kontrole dhe procedura të përshtatshme për identifikimin dhe zbutjen e çdo rreziku operativ që lind gjatë procesit të lëshimit, transferimit ose anulimit të Garancive të Origjinës.
3. ZRRE-së i paguhet një taksë nga Aplikuesit që marrin pjesë në sistemin e Garancive të Origjinës, ndërsa një taksë e tillë bazohet në kostot e justifikuara që lidhen me lëshimin, transferimin dhe anulimin e Garancive të Origjinës dhe për mirëmbajtjen e Regjistrit të Garancive të Origjinës.

Neni 4

E drejta për Garancitë e Origjinës

1. Një certifikatë mbi Garancinë e Origjinës lëshohet për energjinë elektrike të prodhuar nga një Pajisje Gjenerimi në Kosovë dhe të dorëzuar në rrjet, me anë të një kërkesë elektronike të paraqitur në ZRRE nga një prodhues i BRE-ve ose përfaqësuesi i tij.



2. Prodhuksi i BRE-ve do të jetë i kualifikuar për të marrë Garancitë e Origjinës, me kusht që Pajisja e Gjenerimit të jetë e regjistruar në Regjistrin e Garancive të Origjinës dhe pajisjet matëse të jenë në përputhje me standardet teknike të Kodit të Matjes së sistemit të rrjetit përkatës.
3. Garancitë e Origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga Prodhuksi i Energjisë së Ripërtëritshme që përfitojnë nga një skemë mbështetëse në Kosovë i lëshohen subjektit të caktuar për të kryer detyrat e Operatorit të Energjisë së Ripërtëritshme për kohëzgjatjen e periudhës së mbështetjes.

Neni 5 **Regjistri i Garancive të Origjinës**

1. ZRRE-ja mirëmban Regjistrin e Garancive të Origjinës në përputhje me Standardin Evropian CEN 16325, duke përfshirë Parimet dhe Rregullat e Operimit të Sistemit Evropian të Certifikimit të Energjisë. Rexhistri duhet të jetë në gjendje të mbështesë shkëmbimin e të dhënave sipas kërkesave të AIB për transferimin ndërkufitar të Garancive të Origjinës, dhe duhet të zbatojë procedurat e sigurisë dhe auditimit që sigurojnë parandalimin e qasjes së paautorizuar dhe integritetin e të dhënave.
2. Regjistri i Garancive të Origjinës përfshin dy lloje llogarish:
 - 2.1. Llogarinë e Transferueshme, dhe
 - 2.2. Llogarinë e Anulimit.
3. ZRRE-ja në përputhje me mandatin e saj ligjor, ndërmerr masa të arsyeshme për të siguruar korrektësinë, besueshmërinë dhe mbrojtjen nga mashtrimet sa i përket Regjistrin të Garancive të Origjinës dhe merr masa adekuate bazuar në mandatin e saj ligjor në rast të keqpërdorimeve.
4. Regjistri i Garancive të Origjinës është i qasshëm përmes platformës elektronike në përputhje me kërkesat e Ligjit (08/L-258) për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë, kësaj Rregulle dhe legjislacionit tjetër të aplikueshëm.
5. ZRRE-ja do të ruajë të dhënat në Regjistrin e Garancive të Origjinës në një mënyrë që garanton sigurinë e informacionit dhe siguron që:
 - 5.1 Futja e të dhënave lejohet vetëm nga stafi i autorizuar në mënyrën e duhur;
 - 5.2 Nuk janë të lejuara ndryshime në të dhënat mbi rrethanat e regjistruara dhe të fshira, dhe
 - 5.3 Të dhënat ruhen për një periudhë prej dhjetë (10) vitesh.

Neni 6 **Regjistrimi i Pajisjeve të Gjenerimit**

1. Garancitë e Origjinës mund t'u lëshohen vetëm Aplikuesëve për energjinë e prodhuar nga Pajisjet e Gjenerimit të regjistruara.
2. ZRRE-ja regjistron Pajisjen e Gjenerimit pasi pronari i Pajisjes së Gjenerimit apo Operatori i Energjisë së Ripërtëritshme në emër të prodhuesit të pranuar në skemë mbështetëse paraqet



kërkesën në përputhje me dokumentacionin e kërkuar sipas Shtojcës 1a të kësaj rregulle dhe pas dorëzimit të formularit të aplikimit të nënshkruar, sipas Shtojcës 1b të kësaj Rregulle.

3. ZRRE-ja do të verifikojë informacionin e paraqitur nga Aplikuesi, mund të kryejë inspektime në terren ose mund t'i kërkojë Organit Matës të inspektojë Pajisjen e Gjenerimit për të verifikuar përputhshmërinë e Pajisjes së Gjenerimit me kodet teknike përkatëse dhe kodet e matjes në fuqi.
4. Në rast të mungesës ose paqartësisë së të dhënave, ZRRE-ja mund të kërkojë nga Aplikuesi të paraqesë informacione shtesë brenda afatit, sipas paragrafit 5 të këtij Neni.
5. ZRRE-ja e regjistron Pajisjen e Gjenerimit brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike nga marrja e kërkesës sipas paragrafit 2 të këtij Neni, përveç nëse kërkohen informacione shtesë, në të cilin rast Pajisja e Gjenerimit regjistrohet brenda pesë (5) ditëve pune nga data kur informacioni shtesë i kërkuar nga ZRRE-ja është marrë sipas paragrafit 4 të këtij Neni.
6. Kur një aplikim për regjistrimin e një Pajisjeje Gjenerimi është i plotë, ZRRE-ja njofton Aplikuesin dhe përditëson bazën e të dhënave në Regjistrin e Garancive të Origjinës në përputhje me rrethanat për të përfshirë informacionin e mëposhtëm:
 - 1.1. përshkrime të hollësishme të impiantit dhe aparaturës së Pajisjes së Gjenerimit;
 - 1.2. vendndodhjen e Pajisjes së Gjenerimit, duke përfshirë diagramet dhe fotografitë; dhe
 - 1.3. detajet rreth pronarit të Pajisjes së Gjenerimit.
7. Aplikuesi mban përgjegjësi të plotë për saktësinë dhe vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura.
8. Pas regjistrimit të Pajisjes së Gjenerimit, ZRRE do t'i caktojë Pajisjes së Gjenerimit një Numër Unik, dhe Llogaria në Regjistër hapet automatikisht.
9. Regjistrimi i Pajisjes së Gjenerimit është i vlefshëm për pesë (5) vjet, nga data e regjistrimit dhe duhet të ripërtërihet para skadimit pas ri-aplikimit të Aplikuesëve për regjistrimin e Pajisjes së Gjenerimit.
10. Ri-aplikimi për regjistrim të Pajisjes së Gjenerimit, pas skadimit të afatit të regjistrimit nga paragrafi 9 i këtij Neni, bëhet në përputhje me kërkesat e Nenit 6, paragrafit 2 të kësaj Rregulle.

Neni 7

Mirëmbajtja e Pajisjeve të Gjenerimit

1. Pronarët e Pajisjeve të Gjenerimit janë përgjegjës për të njoftuar ZRRE-në për çdo ndryshim në aparaturën e Pajisjeve të Gjenerimit dhe në rast të tillë ZRRE-ja ndryshon bazën e të dhënave në përputhje me rrethanat.
2. ZRRE-ja do të ndalojë regjistrimin e informacionit për Pajisjen Gjeneruese nëse pas regjistrimit kanë ndodhur ndryshime në Pajisjen Gjeneruese dhe këto ndryshime nuk janë deklaruar tek ZRRE-ja.



3. Kur kapaciteti i një Pajisjeje Gjenerimi ekzistuese rritet për çfarëdo arsye, duke përfshirë rinovimin ose përmirësimin e Pajisjes Gjeneruese, atëherë një kapacitet i tillë shtesë duhet të regjistrohet në Regjistrin e Garancive të Origjinës si një element i veçantë i asaj Pajisjeje Gjeneruese me:
 - 3.1. kapacitetin e specifikuar në aplikacionin për regjistrim; si dhe
 - 3.2. datën në të cilën Pajisja e Gjenerimit është bërë funksionale siç specifikohet në Aplikacionin për regjistrim.
4. Pronarët e Pajisjeve të Gjenerimit duhet t'i japin ZRRE-së, ose çdo pale të tretë të autorizuar nga ZRRE-ja, qasje në ambientet dhe të dhënat e tyre për qëllime verifikimi.
5. Çdo ndryshim në pronësinë e Pajisjes së Gjenerimit duhet të reflektohet në Regjistrin e Garancive të Origjinës me kërkesë të pronarit të Pajisjes së Prodhimit.
6. ZRRE-ja është e detyruar të çregjistrojë Pajisjen e Gjenerimit nga Regjistri i Garancive të Origjinës brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike nga data kur Aplikuesi e kërkon këtë ose nëse pronari i Pajisjes së Gjenerimit nuk ka riaplikuar për ripërtëritjen e regjistrimit sipas Nenit 6 të kësaj Rregulle.

Neni 8

Mbajtësit e Llogarive

1. Prodhuesi i BRE-ve, Operatori i Energjisë së Ripërtëritshme në emër të Prodhuesve të BRE-ve me mbështetje, ose furnizuesi, duhet të aplikojë për t'u regjistruar dhe për të hapur Llogarinë sipas Regjistrin të Garancive të Origjinës.
2. ZRRE-ja regjistron Mbajtësit e Llogarive pas dorëzimit të kërkesës me shkrim sipas Shtojcës 2a të kësaj Rregulle.
3. ZRRE-ja hap Llogarinë në Regjistrin e Garancive të Origjinës brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike nga marrja e Aplikimit, përveç nëse ZRRE-ja kërkon informacione shtesë, në të cilin rast Llogaria hapet brenda pesë (5) ditëve nga marrja e informacionit të tillë shtesë.
4. Mbajtësit e Llogarive duhet të përmbushin të gjitha detyrimet për zbulimin, raportimin dhe anulimin e Garancive të Origjinës, siç përcaktohet në këtë Rregull .
5. Çdo pronar i një Llogarie në Regjistrin e Garancive të Origjinës mund të aplikojë në ZRRE për mbylljen e Llogarisë duke dërguar një kërkesë me shkrim.
6. ZRRE-ja do ta mbyllë Llogarinë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike nga marrja e kërkesës së tillë, dhe Llogaria fshihet nga Regjistri i Garancive të Origjinës.
7. Në rast se në Llogarinë e pronarit ka Garanci të Origjinës të vlefshme në kohën e mbylljes, ZRRE-ja informon Mbajtësin e Llogarisë që t'i transferojë Garancitë e Origjinës në një Llogari tjetër.
8. Nëse nuk transferohet te një Mbajtës tjetër i Llogarisë sipas paragrafit 7 të këtij Neni, Garancia e Origjinës anulohet me skadimin e vlefshmërisë.



9. Mbajtësit e Llogarive duhet të ruajnë për një periudhë minimale prej dhjetë (10) vitesh të gjitha dokumentet, të dhënat e matjes dhe të dhënat që lidhen me pjesëmarrjen e tyre në sistemin e Garancive të Origjinës dhe duhet t'i japin ZRRE-së qasje në të dhëna të tilla për qëllime verifikimi.

PJESA III

APLIKIMI PËR LËSHIM, TRANSFERIM DHE ANULIM TË GARANCIVE TË ORIGINËS

Neni 9

Procedura e lëshimit

1. Garancia e Origjinës lëshohet me kërkesë të Prodhuesit të Energjisë nga BRE-të ose përfaqësuesi i tij, ndërsa një kërkesë e tillë mund të mbulojë një ose më shumë muaj kalendarikë, bazuar në të dhënat e verifikuara të matjes të paraqitura nga Organi Matës.
2. Garancia e Origjinës lëshohet me kërkesë të Operatorit të Energjisë së Ripërtëritshme për energjinë elektrike të prodhuar nga Prodhuesit e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë që përfitojnë nga një skemë mbështetëse për kohëzgjatjen e periudhës së mbështetjes, ndërsa një kërkesë e tillë mund të mbulojë një ose më shumë muaj kalendarikë, bazuar në të dhënat e verifikuara të matjes të paraqitura nga Organi Matës.
3. Kërkesa për lëshim duhet të dorëzohet në mënyrë elektronike pas përfundimit të muajit ose periudhës në të cilën gjenerohet energjia elektrike.
4. Garancia e Origjinës ka një madhësi standarde prej një (1) MWh për njësi për energjinë elektrike të injektuar në rrjet.
5. Nëse sasia neto e injektuar në rrjet është më pak se 1 MWh neto, nuk dorëzohet asnjë aplikim dhe sasia e kWh e injektuar i shtohet muajit pasardhës derisa të arrihet 1 MWh prodhim i injektuar.
6. Nëse sasia e deklaruar tejkalon 1 MWh, pjesa e mbetur i shtohet automatikisht Gjenerimit të muajit pasardhës.

Neni 10

Lëshimi

1. ZRRE lëshon Garancinë e Origjinës dhe e regjistron atë në Regjistrin e Garancive të Origjinës ose refuzon lëshimin e Garancisë së Origjinës jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga data e aplikimit sipas Nenit 9, paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të kësaj Rregulle, ose jo më vonë se pesë (5) ditë nga data kur dokumentet shtesë të kërkuara janë paraqitur sipas paragrafit 2 të këtij Neni.
2. Nëse gjenden parregullsi, ZRRE-ja njofton palën që të korrigjojë aplikimin brenda pesë (5) ditë pune nga data e njoftimit.
3. Kur pala që kërkon lëshimin e Garancisë së Origjinës nuk arrin të paraqesë informacionin e kërkuar nga ZRRE-ja, Garancia e Origjinës nuk lëshohet, dhe energjia elektrike e gjeneruar nuk është e përshtatshme për Garancitë e Origjinës, duke u alokuar në Përzierjen e Mbetur.



4. ZRRE-ja do të përdorë të dhënat e matjes së Organit Matës si provë parësore në verifikimin e vëllimeve të prodhimit, ndërsa në rast të mospërputhjeve midis Aplikimit dhe të dhënave të Organit Matës, këto të fundit do të mbizotërojnë.
5. Nga data kur ZRRE lëshon certifikatën e Garancisë së Origjinës, Aplikuesi bëhet mbajtës i asaj Garancie të Origjinës.
6. Një Garanci Origjine, që nga lëshimi, është e vlefshme për dymbëdhjetë (12) muaj, duke filluar nga dita e fundit e periudhës së gjenerimit për të cilën është lëshuar dhe anulohet jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas përfundimit të vlefshmërisë së saj.
7. Garancia e Origjinës e lëshuar përfshihet në Përzierjen e Mbetur nëse nuk përdoret brenda periudhës dymbëdhjetë (12) mujore.

Neni 11 **Përmbajtja e Garancisë së Origjinës**

1. Garancia e Origjinës duhet të specifikojë nëse lidhet me:
 - 1.1. Energjinë elektrike;
 - 1.2. Gazin, përfshirë hidrogjenin;
 - 1.3. Ngrohjen ose ftohjen
 - 1.4. Identitetin, vendndodhjen, llojin dhe kapacitetin e instalimit ku është gjeneruar energjia;
 - 1.5. Nëse instalimi ka përfituar nga skema e mbështetjes dhe lloji i mbështetjes;
 - 1.6. Datën në të cilën instalimi është bërë funksional; dhe
 - 1.7. Datën dhe vendin e lëshimit dhe një numër unik identifikimi.
2. Për hidrocentralet që përfshijnë sistem të magazinimit me pompim, Garancitë e Origjinës lëshohen vetëm për prodhimin e injektuar që mund t'i atribuohet rrjedhjes natyrore.

Neni 12 **Transferimi**

1. Garancia e Origjinës mund të transferohet gjatë periudhës së vlefshmërisë së saj dhe kërkesa për transferim bëhet në çdo kohë gjatë periudhës së vlefshmërisë së Garancisë së Origjinës por jo më vonë se njëzet e një (21) ditë kalendarike para skadimit të Garancisë së Origjinës.
2. Periudha e vlefshmërisë së Garancisë së Origjinës së transferuar nuk do të ndryshohet.
3. Kërkesa për transferim i dorëzohet në mënyrë elektronike ZRRE-së nga mbajtësi i Garancisë së Origjinës.
4. ZRRE-ja miraton ose refuzon transferimin e Garancisë së Origjinës brenda dhjetë (10) ditë pune nga kërkesa dhe lëshon një Garanci të Origjinës të amendamentuar duke treguar pronarin e ri si Mbajtës dhe regjistron ndryshimin në Regjistrin e Garancive të Origjinës.
5. Pas miratimit të transferimit, Garancia e Origjinës së transferuar hiqet nga Llogaria e Transferueshme e shitësit.



6. Garancia e Origjinës në Llogarinë e Anulimit nuk mund të transferohet.
7. ZRRE-ja do ta refuzojë transferimin nëse kërkesa për transferim nuk i përmbush kushtet e këtij Neni.
8. Garancia e Origjinës mund të transferohet në mënyrë të pavarur nga shitja e energjisë së gjeneruar me të cilën lidhet.

Neni 13 Anulimi

1. Garancia e Origjines anulohet me qëllim që të ofrojë prova nga furnizuesi te konsumatori fundor se një sasi e caktuar e energjisë elektrike të konsumuar është prodhuar nga BRE.
2. Një Garanci Origjine anulohet pas përdorimit, konsiderohet e përdorur kur i transferohet një konsumatori fundor ose anulohet me skadimin e vlefshmërisë së saj.
3. Nëse nuk transferohet, Garancia e Origjinës anulohet automatikisht nga ZRRE-ja jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas përfundimit të vlefshmërisë.
4. Garancia e Origjinës e papërdorur pas tetëmbëdhjetë (18) muajsh përfshihen në Përzierjen e Mbetur.
5. Garancia e Origjinës anulohet nëse atë e tërheq ZRRE-ja nga Regjistri i Garancive të Origjinës.
6. Nëse transferohet te konsumatorët fundorë, anulimi është automatik me njoftimin e ZRRE-së nga furnizuesi.
7. Furnizuesi, duke qenë Mbajtës i Llogarisë në Regjistrin e Garancive të Origjinës, duhet të paraqesë në ZRRE kërkesë për anulim të Garancisë së Origjinës të përdorur, jo më vonë se 30 Prilli i vitit pasardhës.
8. Garancia e Origjinës e anuluar regjistrohet nga ZRRE-ja në Regjistrin e Garancive të Origjinës dhe do të përfshihet në llogaritjen e Përzierjes së Mbetur.
9. Garancia e Origjinës e anuluar hiqet nga qarkullimi.

Neni 14 Tërheqja e Garancisë së Origjinës

1. ZRRE-ja do të tërheqë Garancinë e Origjinës në rast se identifikohen gabime ose parregullsi.
2. Njoftimi i tërheqjes duhet të specifikojë arsyet që përmbajnë bazat për tërheqjen.
3. ZRRE-ja nuk ka detyrim të mbulojë kostot administrative në rast të tërheqjes së Garancive të Origjinës.
4. Pas tërheqjes, Garancia e Origjinës nuk është e vlefshme dhe nuk mund të transferohet ose anulohet.

Neni 15 Transparenca e Regjistrit të Garancive të Origjinës

1. ZRRE-ja do të publikojë informacionin përkatës mbi Garancitë e Origjinës në faqen e saj elektronike, në veçanti:



- 1.1. Listën e Mbajtësve të Llogarive të Regjistrimit të Garancive të Origjinës;
 - 1.2. Listën e Pajisjeve të regjistruara të Gjenerimit;
 - 1.3. Numrin e Garancive të Origjinës të lëshuara;
 - 1.4. Numrin e Garancive të Origjinës të transferuara në Republikën e Kosovës;
 - 1.5. Numrin e Garancive të Origjinës të transferuara nga Republika e Kosovës në shtete të tjera;
 - 1.6. Numrin e Garancive të Origjinës të transferuara nga shtete të tjera në Republikën e Kosovës;
 - 1.7. Numrin e Garancive të Origjinës të Anuluara;
 - 1.8. Numrin e Garancive të Origjinës që kanë skaduar.
2. ZRRE-ja do të publikojë informacionin përkatës mbi Pajisjet e Regjistruara në faqen e saj elektronike, në veçanti:
 - 2.1. Emrin e Pajisjes së Gjenerimit;
 - 2.2. Kapacitetin e instaluar të Pajisjes së Gjenerimit;
 - 2.3. Datën e vënies në funksion të Pajisjes së Gjenerimit, dhe
 - 2.4. Llojin e Burimit të Energjisë së Ripërtëritshme që përdoret për gjenerimin e energjisë elektrike.
 3. ZRRE do të përditësojë Regjistrin e Garancive të Origjinës në vazhdimësi dhe pas çdo përditësimi në Regjistrin e Garancive të Origjinës publikohen të dhënat e përditësuara.
 4. Informacioni i ndarë sipas këtij neni duhet të marrë parasysh kufizimet nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin e biznesit.

PJESA IV

PUBLIKIMI I BURIMEVE TË ENERGJISË, NJOHJA E GARANCIVE TË ORIGINËS DHE DETYRIMET E ORGANIT MATËS

Neni 16 Përzierja e Mbetur

1. ZRRE-ja llogarit Përzierjen e Mbetur për zbulimin e vitit X, duke mbuluar periudhën 1 Prill të vitit X deri më 31 Mars të vitit X+1.
2. ZRRE-ja duhet të sigurojë që llogaritja e Përzierjes së Mbetur të jetë në përputhje me kriteret dhe kërkesat e aplikuara sipas përzierjes së mbetur evropiane të publikuar çdo vit nga AIB dhe kërkesat e CEN EN 16325 dhe EECS, duke shmangur çdo numërim të dyfishtë ose mungesë të attributeve.
3. Kur llogarit Përzierjen e Mbetur, ZRRE-ja duhet të marrë parasysh të paktën:



- 3.1. Prodhimin e injektuar të energjisë elektrike sipas burimit në Kosovë për vitin X, bazuar në të dhënat e marra nga Organi Matës;
- 3.2. Garancitë e Anuluara të Origjinës dhe gjurmime të tjera të besueshme të përdorura për zbulimin brenda 1 Prillit të vitit X deri më 31 Mars të vitit X+ 1;
- 3.3. Garancitë e Origjinës të skaduara ose të papërdorura që lidhen me vitin X; Atributet e importuara dhe eksportuara sipas burimit, në përputhje me procedurat e AIB-së, dhe
- 3.4. Konsumin total të energjisë elektrike dhe shitjet të konsumatorët fundorë, duke përfshirë humbjet në sistem.

Neni 17

Publikimi i pjesëmarrjes së të gjitha burimeve të energjisë

1. ZRRE-ja, deri më 31 maj të çdo viti, publikon përqindjet e të gjitha llojeve të burimeve të energjisë për prodhimin e energjisë elektrike në Republikën e Kosovës.
2. Llogaritja duhet të marrë parasysh:
 - 2.1. Të dhënat mbi energjinë elektrike të prodhuar nga secila Pajisje e Gjenerimit në Republikën e Kosovës, e lidhur me sistemin e transmetimit ose shpërndarjes;
 - 2.2. Të dhënat mbi totalin e energjisë elektrike të shitur të të gjithë konsumatorët fundorë;
 - 2.3. Të dhëna mbi humbjet e energjisë elektrike nga sistemi i transmetimit ose shpërndarjes;
 - 2.4. Të dhëna mbi Garancitë e Origjinës të përdorura, të skaduara dhe të anuluar midis 1 Prillit të vitit X dhe 31 Marsit të vitit X+ 1;
 - 2.5. Importet dhe eksportet, në përputhje me metodologjinë Evropiane të Përzierjes së Atributeve, të publikuar çdo vit nga Shoqata e Organeve Lëshuese (AIB).
3. Publikimi i referuar paragrafit 1 dhe paragrafit 2 të këtij Neni, publikohet në faqen elektronike të ZRRE-së dhe duhet të marrë parasysh Garancitë e Origjinës të lëshuara për qëllim të llogaritjes së Përzierjes së Mbetur.

Neni 18

Deklarimi nga furnizuesi

1. Furnizuesit janë të detyruar të llogarisin një herë në vit të gjitha llojet e burimeve të energjisë elektrike të shitur për vitin paraprak dhe të shpërndajnë këtë informacion në faturat e energjisë elektrike të lëshuara për konsumatorët fundor, si dhe në materialet promovuese.
2. Furnizuesit përdorin deklarinin bazë të Përzierjes së Mbetur, të publikuar nga ZRRE-ja.
3. Publikimi dhe shpërndarja në faturat e energjisë elektrike, sipas paragrafit 1 të këtij neni, bëhet midis 1 dhe 31 korrikut të çdo viti dhe publikohet në faqen elektronike të furnizuesit.
4. ZRRE-ja do të mbikëqyrë furnizuesit për saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave të publikuara.
5. ZRRE-ja mund të lëshojë udhëzime të veçanta për furnizuesit mbi mënyrën e deklaramit të pjesëmarrjeve të të gjitha llojeve të burimeve të shitura të energjisë.



Neni 19 **Njohja e Garancive të Origjinës**

1. Një Garanci Origjine e lëshuar nga një Shtet Anëtar i Bashkimit Evropian ose një Palë tjetër Kontraktuese e Komunitetit të Energjisë në parim do të njihet në Republikën e Kosovës, me kusht që:
 - 1.1. një Garanci Origjine përmban elementet e përmendura në Nenin 11 të kësaj Rregulle, dhe
 - 1.2. nuk ka bazë për refuzim sipas paragrafëve dy (2) dhe tre (3) të këtij Neni.
2. Kur ekzistojnë dyshime të bazuara mbi saktësinë, besueshmërinë ose vërtetësinë e një Garancie të Origjinës të lëshuar nga një Shtet Anëtar i Bashkimit Evropian ose nga një Palë Kontraktuese e Bashkësisë së Energjisë, ZRRE-ja duhet të refuzojë njohjen e asaj Garancie të Origjinës.
3. Përveç paragrafit 2 të këtij neni, arsyet e refuzimit mund të lidhen edhe me njohjen reciproke të Garancive të Origjinës të lëshuara nga një Shtet tjetër Anëtar i Bashkimit Evropian ose nga një Palë Kontraktuese e Komunitetit të Energjisë.
4. ZRRE-ja, në çdo rast të refuzimit të njohjes, njofton Ministrinë për arsyet e një refuzimi të tillë.

Neni 20 **Organi Matës**

1. Organi Matës duhet t'i paraqesë ZRRE-së të dhënat nga matësit e Pajisjes së regjistruar të Gjenerimit për energjinë elektrike të injektuar në rrjet, për qëllime të Regjistrimit të Garancive të Origjinës, një herë në muaj në përputhje me kërkesat e kodit përkatës të matjes të Organit Matës.
2. ZRRE-ja mund të kërkojë që Organi Matës të ofrojë informacion ose shërbime në lidhje me konfirmimin e përputhshmërisë së matësve të Pajisjes së Gjenerimit ose çdo informacion tjetër për qëllime të Garancive të Origjinës, sipas nevojës.
3. Organi Matës mban përgjegjësi për saktësinë, integritetin dhe kohëzgjatjen e të dhënave të matjes të paraqitura.

Neni 21 **Ankesat**

Kur një Aplikues paraqet një ankesë, ZRRE-ja duhet ta zgjidhë atë në përputhje me rregullat e miratuara nga ZRRE-ja për zgjidhjen e ankesave dhe mosmarrëveshjeve në sektorin e energjisë

PJESA V

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 22 **Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulle, shfuqizohet “Rregulla për krijimin e sistemit të Certifikatave të Origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtërishme, mbeturinat si dhe nga bashkëprodhimi i kombinuar me nxehtësinë, në një njësi të vetme gjeneruese”, të nxjerr nga Bordi i ZRRE-së me datë 29 dhjetor 2010.



Neni 23 **Gjuha zyrtare**

Kjo Rregull publikohet në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës. Në rast të mospërputhjeve midis versioneve, do të mbizotëroj versioni në gjuhën shqipe.

Neni 24 **Modifikimi**

1. ZRRE ka të drejtë të ndryshojë ose modifikojë çdo dispozitë të kësaj Rregulle.
2. Procedura për ndryshimin ose modifikimin e kësaj Rregulle do të jetë e njëjtë me atë të miratimit të saj.


Neni 25 **Interpretimi**


Nëse ka paqartësi në lidhje me dispozitat e kësaj Rregulle, Bordi i ZRRE-së do të lëshojë informacion shpjegues.

Neni 26 **Hyrja në fuqi**


1. Rregulla hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së.
2. Rregulla publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.


Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Lutfie Dervishi, anëtare


Gani Buçaj, anëtar


Arta Isufi, anëtare


Adnan Preniqi, anëtar



SHTOJCA 1a – KËRKESAT PËR PAJISJEN E GJENERIMIT

1. Për regjistrimin e Pajisjes së Gjenerimit në Regjistrin e Garancive të Origjinës, Aplikuesi i paraqet ZRRE-së informacionin si më poshtë:
 - 1.1. Emrin dhe mbiemrin dhe adresën dhe, nëse është kompani, edhe numrin unik të identifikimit të personit që kërkon regjistrimin e Pajisjes së Gjenerimit;
 - 1.2. Emrin, vendndodhjen dhe numrin e identifikimit dhe çdo informacion tjetër të kërkuar për të identifikuar në mënyrë unike njësinë/njësitë Gjeneruese për të cilat kërkohet regjistrimi.
 - 1.3. Teknologjinë e njësisë gjeneruese dhe burimin ose burimet e energjisë që mund të përdoren në gjenerimin e energjisë elektrike në njësinë gjeneruese;
 - 1.4. Kapacitetin e deklaruar të njësisë gjeneruese dhe datën kur është bërë funksionale;
 - 1.5. Detajet e matësit/matësve të eksportit për njësinë gjeneruese;
 - 1.6. Detajet e çdo pajisjeje ndihmëse gjeneruese të lidhur me njësinë gjeneruese;
 - 1.7. Kur ekzistojnë pajisje ndihmëse të lidhura me njësinë gjeneruese dhe konsumi i këtyre pajisjeve nuk përcaktohet nga një matës eksporti, të dhëna për matësin/matësit e importit që përcaktojnë konsumin e energjisë elektrike nga njësia gjeneruese;
 - 1.8. Një përshkrim se si do të llogaritet sasia e gjenerimit të energjisë elektrike nga njësia gjeneruese nga leximet e matësve që do të ofrohen;
 - 1.9. Informacion mbi mbështetjen që ka marrë njësia gjeneruese.



SHTOJCA 1b: FORMULARI I REGJISTRIMIT TË PAJISJES

APLIKIM PËR REGJISTRIMIN E PAJISJES GJENERUESE NË REGJISTRIN E GARANCIVE TË ORIGINJËS	
Regjistrimi / Çregjistrimi	Data:
I. Informacion bazë	
ID-ja e personit që aplikon	
Emri i Mbajtësit të Llogarisë (emri i kompanisë së subjektit juridik ose emri dhe mbiemri i personit fizik)	
Aplikuesi është pronar i Pajisjes së Gjenerimit	Po / Jo*
Gjendja e Gjeneratorit	Prodhuar i BRE-ve sipas skemës së mbështetjes ☐ Prodhuar i Pavarur i Energjisë së Ripërtërishme ☐
II. Informacion mbi Pajisjen e Gjenerimit	
Emri	
Adresa	
Vendndodhja	
Data e Vënies në Funksion	
Kapaciteti i instaluar (MW)	
Prodhim i vjetor i vlerësuar (MWh)	
Operatori i Sistemit (Organi Matës)	
Niveli i rrjetit (kV)	
Teknologjia	

Duke nënshkruar këtë aplikacion, unë konfirmoj vërtetësinë e të dhënave dhe sa vijon:

- Unë jam i autorizuar për të aplikuar për regjistrimin e Pajisjes së Gjenerimit
- Unë lejoj që ZRRE-ja të regjistrohet për Pajisjen e Gjenerimit në Regjistrin e Garancive të Originës në emrin tim.
- Unë i ofroj ZRRE-së, ose çdo pale të tretë të autorizuar nga ZRRE-ja, qasje në ambientet dhe të dhënat e Pajisjes së Gjenerimit për qëllime verifikimi.
- Unë do të mbuloj shpenzimet e regjistrimit të Pajisjes Gjeneruese.

Data: _____

Emri dhe mbiemri: _____

Nënshkrimi dhe vula: _____



SHTOJCA 2a – FORMULARI I APLIKIMIT PËR MBAJTËSIN E LLOGARISË

KËRKESË PËR HAPJEN E LLOGARISË NË REGJISTRIN E GARANCIVE TË ORIGINËS	
Emri i Mbjtësit të Llogarisë (emri i kompanisë së subjektit juridik ose emri dhe mbiemri i personit fizik)	
Numri i TVSH-së/numri i identifikimit	
Personi përgjegjës (Emri dhe mbiemri, e-mail, Numri i telefonit/celularit, Funkcioni)	
Personi Kontaktues (Emri dhe mbiemri, e-mail, Numri i telefonit/celularit)	
E-mail	
Numri i licencës për kryerjen e aktiviteteve energjetike (e zbatueshme për prodhuesit dhe furnizuesit)	

DOKUMENTE PËR T'U BASHKËNGJITUR	
Dokumentet e regjistrimit të subjektit juridik/dokumenti i identifikimit për personin fizik	Po ☐ Jo ☐
Dokumente shtesë që Aplikuesi paraqet (opsionale):	

Duke nënshkruar këtë aplikacion, unë konfirmoj vërtetësinë e të dhënave dhe sa vijon :

- Unë jam i autorizuar për të aplikuar për regjistrim si Mbjtës i Llogarisë
- Unë lejoj që ZRRE-ja të hapë Llogarinë në Regjistrin e Garancive të Originës në emrin tim.
- Unë do të mbuloj shpenzimet e regjistrimit dhe mirëmbajtjes së Llogarisë
- Unë do të veproj në përputhje me kërkesat e Rregullës për Garancitë e Originës.

Data: _____

Emri dhe mbiemri: _____

Nënshkrimi dhe vula: _____